



Termet e referencës

Për angazhimin e një eksperti/eje të ekonomisë/agrokulturës

Titulli i aktivitetit:

Përgatitja e biznes planeve të thjeshta me gratë të cilat kualifikohen për të përfituar nga përkrahja jo-monetare¹.

Projekti	“Stand for HER Property”
Kontrata	Ekspert/e
Data	Prill 2020
Ditët e planifikuara	Deri në 30 ditë angazhimi
Aktiviteti	Përgatitja e biznes planeve të thjeshta me gratë të cilat kualifikohen për të përfituar nga përkrahja jo-monetare
Vendi	Aktiviteti do të realizohet përmes komunikimit virtual (gjatë periudhës së pandemisë) dhe/ose vizitave dhe kontaktit të drejtpërdrejtë (pas periudhës së pandemisë) me gratë përfituese dhe familjarët e tyre.

Përshkrim i përgjithshëm

Kosova – Women 4 Women kërkon të angazhojë një ekspert/e të ekonomisë/agrokulturës në mbështetjen e grave për të përgatitur plane të thjeshta të biznesit. Planet e biznesit do të përgatiten për gratë të cilat janë kualifikuar për t’u mbështetur me përkrahje jo-monetare, duke u bazuar në kërkesat individuale të tyre.

Ky angazhim është i parashikuar si aktivitet në kuadër të projektit ‘Stand for HER property’ që ka për qëllim ngritjen e vetëdijes së grave, fëmijëve dhe të rinjve për të drejtat e tyre pronësore si dhe inkurajimin e grave për ta gëzuar këtë të drejtë. Ky projekt është duke u implementuar nga Kosova – Women 4 Women në kuadër të Programit Angazhimi për Barazi – E4E, i financuar nga Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) dhe zbatuar nga Qendra e Trajnimeve dhe Burimeve për Avokim (ATRC).

¹ Përkrahje që do të ofrohet do të jetë jo-monetare, e që nënkupton përkrahje në formë të pajisjeve, mjeteve të punës, materialeve bujqësore (fara, fidane, sisteme për ujitje, rrethoja, pjesë për sera, etj.) apo të mirave tjera.



1. OBJEKTIVAT E KONTRATËS & REZULTATET E PRITSHME

1. Qëllimi

Qëllimi i këtij aktivitetit është mbështetja e pesëmbëdhjetë grave të cilat do të përfitojnë nga kjo përkrahje jo-monetare në përgatitjen e biznes planeve të thjeshta varësisht nga ekonomitë/bizneset e tyre familjare. Qëllimi kryesor i këtij aktiviteti është fuqizimi ekonomik i grave duke ju mundësuar përkrahje në formë të pajisjeve, varësisht nga kërkesat dhe nevojat e tyre. Këto pajisje do të shfrytëzohen për agrokulturë apo zhvillim të biznesit, si dhe për ofrimin e një baze solide për stabilitet financiar.

1.1. Detyrat e ekspertit/es

Eksperti/ja nën drejtimin e koordinatores së projektit dhe në bashkëpunim me ekipin e projektit do të jetë përgjegjës/e për përgatitjen e planeve të thjeshta të bizneseve por të qëndrueshme dhe të realizueshme në përputhje me kërkesat specifike dhe ekonomitë e tyre familjare të përfitueseve.

1.2. Detyrat specifike

1. Përgatitja e një plani të punës
2. Bashkëpunim dhe komunikim i afërt me gratë e referuara nga Kosova – Women 4 Women dhe familjarët e tyre
3. Përgatitja e biznes planeve për në bazë të informative të pranuar nga gratë e referuara
4. Raport final i përmbledhur me aktivitetet e zhvilluara dhe ditët e angazhimit

2. LOGJISTIKA DHE KOHA

2.1 Vendi dhe periudha e ekzekutimit

Eksperti/ja do të jetë i/e angazhuar mesatarisht nga dy ditë pune për secilën përfituese të referuar nga Kosova – Women 4 Women dhe nuk duhet të tejkaloj 30 ditë pune angazhimi në total. Për shkak të gjendjes së krijuar nga pandemia COVID-19, aktiviteti fillimisht pritet që do të zhvillohet virtualisht (komunikimit virtual në mes të ekspertit/tes dhe përfituese së referuar nga KW4W) duke vazhduar edhe me komunikim të drejtpërdrejtë (në rast të nevojës) pas përfundimit të pandemisë.

Aktiviteti pritet të filloj zbatimin në fund të muajit prill.



3. NJOHURITË, AFTËSITË DHE KUALIFIKIMET E KËRKUARA

- Të paktën niveli Bachelor (BA) në Menaxhim Biznesi, Bujqësi apo fusha të tjera relevante
- Eksperiencë relevante dhe ekspertizë në përgatitjen e biznes planeve
- Aftësi të mira menaxhuese, organizative, planifikuese dhe komunikuese
- Përvojë **tre** (3)vjeçare në bujqësi, biznes dhe financa

Kandidatët që i plotësojnë kushtet minimale duhet ta dërgojnë CV-në dhe ofertën me shumë për ditë pune në adresën: human.resources@k-w4w.org. Dokumentet e kërkuara pranohen deri me 25 prill 2020. Aplikimet që pranohen pa informacione dhe dokumente të kërkuara, nuk do të merren në shqyrtim.